



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Adresa:Fushe-Arrez,Prefektura Shkoder ,Email:info@bashkiafushearrez.gov.al

Fushë-Arrëz më, 17/08/2023

### Procesverbal -Tipi i kontratës - Mallra

#### PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje paisje të teknologjisë dhe informacionit për projektin NJVNRR-shërbim për komunitetin financiar nga BE”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** 30213300-8 - Kompjuter desktop, 32324100-1 - Televizor me ngjyra, 32342300-5 - Mikrofonë dhe komplete folëse, 38651000-3 - Kamera

**VLERA E FONDIT LIMIT – 1,510,860 (një milion e peseqind e dhjete mijë e teteqind e gjashtedhjetë) lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, neni 77, pika 3, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 40, pika 5, gërma a, pika 6, gërma a autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Fushë-Arrëz**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve tenike dhe kriterëve për kualifikimin për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertës", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar; citojmë Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", Neni 82, i LPP "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".

## 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

### 1.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe shtojcës 7 të DST-së.

### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2020, 2021, 2022) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të ketë një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit që prokurohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr.922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

**2.2.2.** Kopje të certifikuara të bilanceve të dy viteve të fundit (2021, 2022) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe

pasivit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

**2.2.3.** Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kështu për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

**Shënim:** Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi fitues përpara dhënies së kontratës.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, nëni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

- a) Operatori ekonomik për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë kontrata të shoqëruara me vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara të nënshkruara nga të dyja palët.

ose

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përllogarituar të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme të ISO-ve, (të përkthyer në shqip dhe të noterizuara) të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si mëposhtë:

- ISO 9001:2015-Sistem për menaxhimin e cilësisë, ose ekuivalente;
- ISO 27001:2013-Sistem për menaxhimin e sigurisë së informacionit, ose ekuivalente.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 dhe 79 të LPP, të pikës 1, nenit 44, të VKM-së nr. 285 datë 09.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë sipas objektit të kësaj kontrate. Certifikimi ISO 9001:2015 është standarti më i njohur që është publikuar ndonjëherë në nivel ndërkombëtar. Ai përcakton kërkesat për një sistem menaxhial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilën AK kërkon ta kryejë me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij që të kërkojë certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, që përpos punimeve që do të kryhen nga operatorët ekonomik ofertues, të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme .

Certifikimi ISO 27001:2013 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke siguruar që informacionet të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikëpamja informatike dhe të jenë të kontrolluara, si dhe aksesimi mbi to të jetë i verifikueshëm e i kodifikuar, dhe kjo kërkon kompetencë të shtuar profesionale në këtë drejtim, meqënëse është edhe furnizim-vendosje.

**Commented [u1]:** Bëra sistemim të formës si e ke kërkuar duke respektuar ose ekuivalente si dhe pjesën sipas fushës se ato lëshohen për fushën e veprimtarisë që subjekti ka, dhe nëse e ka pajisje elektronike në ekstrakt do e ketë dhe në certifikatat ISO.

2.3.3 Operatori ofertues duhet të paraqesë katalog/ët ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit për të gjitha produktet. Në to duhet të jenë pasqyruara produkti dhe specifikimet teknike të tij. Katalog/ët ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit, duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të tregojnë lehtësisht se cilit produkt dhe cilit prodhues i përkasin.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 6/b e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë që malli që ata disponojnë dhe tregtojnë është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga firma prodhuese për zërat 1, 8 dhe 9 ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi (distributori duhet të vërtetojë se është autorizuar nga prodhuesi) për mallrat e sipërpërmendura. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që janë të autorizuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për tregtimin e mallit dhe kryerjen e shërbimeve dhe riparimeve në rast defekti, brenda periudhës së garancisë. Në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor ka garanci që po hyn në marrëdhënie kontraktuale me një operator ekonomik serioz në treg, që ka autorizim për kryerjen e aktivitetit objekt prokurimi dhe siguron lidhjen përkatëse me subjektin që ka dhënë autorizimin.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë të punësuar/me kontratë angazhimi, punonjësit si më poshtë:

- a) 1 (një) inxhinier elektronik ose IT (diplomë dhe/ose certifikata të kualifikimeve);
- b) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në nivel teknik për instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve elektronike “Bashkëpunëtor i certifikuar për zgjidhjet e produkteve Microsoft -Windows 10”, ose ekuivalent.
- c) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në nivel teknik për instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve elektronike “Ekspert i certifikuar për zgjidhjet e produkteve Microsoft -Produktiviteti”, ose ekuivalent.
- d) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në nivel teknik për instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve elektronike “Trajner i certifikuar për produktet Microsoft”, ose ekuivalent.
- e) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në nivel teknik për instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve audio/video.

Për të vërtetuar kualifikimet, eksperiencën e punës dhe profilet e stafit të punonjësve si më sipër, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin provues, si më poshtë:

- a) CV;
- b) Kontratë pune ose kontratë angazhimi me operatorin ekonomik.
- c) Listëpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi për punonjësit që i ka të siguruar me kontratë pune.

Kriteri 2.3.5 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b,c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht:

Për kriterin në pikën a), gjykohet se është e nevojshme disponibiliteti i të paktën 1 (një) specialisti të certifikuar në fushën IT-së për pajisjet elektronike që do të ofrohen nga OE. Nisur nga fakti që pjesë e objektit të prokurimit është furnizim/vendosje me pajisje: kompjutera, kamera web, wireless, pajisje audio e lëvizshme, pajisje foto-video, pajisje TV dhe sistem kamerash vëzhgimi, kohëzgjatja e implementimit mund të konsiderohet e kufizuar, duhet që OE të ketë në stafin e tij 1 (një) inxhinier elektronik ose IT, specialist për të mundësuar instalimin dhe vendosjen në gjendje pune me funksionalitet të plotë të gjithë pajisjeve elektronike, sipas përcaktimeve në specifikimet teknike, si dhe për të suportuar/mirëmbajtur ato gjatë kohës së garancisë.

Për kriterin në pikën b), duke qenë se pjesë e prokurimit janë kompjutera, kamera web, wireless, pajisje audio e lëvizshme, pajisje foto-video, pajisje TV dhe sistem kamerash vëzhgimi është e nevojshme që OE të ketë në stafin e tij të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në nivel teknik për instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve elektronike “Bashkëpunëtor i certifikuar për zgjidhjet e produkteve Microsoft -Windows 10”, ose ekuivalent për të mundësuar instalimin, konfigurimin dhe vendosjen në gjendje pune me funksionalitet të plotë, sipas përcaktimeve të specifikimit teknike, të të gjithë pajisjeve të sipërpërmendura që përdorin/përdoren në sistemet e operimit Windows 10. Niveli i kërkuar në këtë pikë garanton profesionalizëm dhe njohuri teknike të avancuara specifike në sistemet e operimit windows 10, sistem i përdorur nga të gjithë pajisjet e sipërpërmendura, si dhe për të suportuar/mirëmbajtur ato pajisje gjatë kohës së garancisë.

Për kriterin në pikën c), duke qenë se pjesë e prokurimit janë kompjutera, kamera web, wireless, pajisje audio e lëvizshme, pajisje foto-video, pajisje TV dhe sistem kamerash vëzhgimi është e nevojshme që OE të ketë në stafin e tij të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në nivel teknik për instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve elektronike “Ekspert i certifikuar për zgjidhjet e produkteve Microsoft-Produktiviteti”, ose ekuivalent për të mundësuar instalimin, konfigurimin dhe vendosjen në gjendje pune me funksionalitet të plotë, sipas përcaktimeve të specifikimit teknike, të të gjithë pajisjeve të sipërpërmendura që përdorin zgjidhjet e produkteve Microsoft ose të ngjashëm. Niveli i kërkuar në këtë pikë garanton profesionalizëm dhe njohuri teknike të avancuara specifike në

**Commented [u2]:** Duke qenë se është kërkuar shumë staf dhe specific duhet patjetër një argumentim teknik për secilin se ku duhen. APP kur asiston argumentimin teknik në këto raste e ka shumë të rëndësishëm.

**Commented [u3]:** Duke qenë se është kërkuar shumë staf dhe specific duhet patjetër një argumentim teknik për secilin se ku duhen. APP kur asiston argumentimin teknik në këto raste e ka shumë të rëndësishëm.

zgjdhjet e produkteve Microsoft ose të ngjashëm, të përdorur nga të gjithë pajisjet e sipërpërmendura si dhe për të suportuar/mirëmbajtur ato gjatë kohës së garancisë.

Për kriterin në pikën d), duke qenë se pjesë e prokurimit janë kompjutera, kamera web, wireless, pajisje audio e lëvizshme, pajisje foto-video, pajisje TV dhe sistem kamerash vëzhgimi është e nevojshme që OE të ketë në stafin e tij të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në nivel teknik për instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve elektronike "Trajner i certifikuar për produktet Microsoft", ose ekuivalent për të mundësuar trajnimin e stafit për instalimin, konfigurimin dhe vendosjen në gjendje pune me funksionalitet të plotë, sipas përcaktimeve të specifikimit teknike, të të gjithë pajisjeve të sipërpërmendura që përdorin zgjidhjet e produkteve Microsoft ose të ngjashëm. Niveli i kërkuar në këtë pikë garanton profesionalizëm dhe njohuri teknike të avancuara specifike në nivel trajneri për të trajnuar stafin e Autoritetit Kontraktor me zgjidhjet e produkteve Microsoft ose të ngjashëm, të pajisjeve të sipërpërmendura, si dhe për të suportuar/mirëmbajtur ato gjatë kohës së garancisë.

Për kriterin në pikën e), duke qenë se pjesë e prokurimit janë: kamera web, pajisje audio e lëvizshme, pajisje foto-video, pajisje TV dhe sistem kamerash vëzhgimi është e nevojshme që OE të ketë në stafin e tij të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në nivel teknik për instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve audio/video për të mundësuar instalimin, konfigurimin dhe vendosjen në gjendje pune me funksionalitet të plotë, sipas përcaktimeve të specifikimit teknike, të të gjithë pajisjeve të sipërpërmendura audio-video. Niveli i kërkuar në këtë pikë garanton profesionalizëm dhe njohuri teknike të avancuara specifike në fushën audio-vizuale, si dhe për të suportuar/mirëmbajtur këto pajisje gjatë kohës së garancisë.

2.3.6 Deklarimin nga Operatori Ekonomik të stafit të angazhuar (emër mbiemër) profilit e tyre (fushën dhe vitet e eksperiencës) dhe citimin e dokumentacionit provues të kërkuar për secilin prej tyre (diplomë dhe/ose certifikata të kualifikimeve).

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të deklarojë që merr përsipër transportin e pajisjeve pranë ambjenteve të Autoritetit Kontraktor brenda afatit të parashikuar duke përfshirë montimin, instalimin, konfigurimin e mallrave të lëvruara.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, neni 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se do të kryejnë transportin e mallrave objekt prokurimi në adresën e autoritetit kontraktor, instalimin konfigurimin e këtyre mallrave.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë se mallrat objekt prokurimi janë në përputhje me specifikimet teknike.

**Commented [u4]:** Duke qenë se është kërkuar shumë staf dhe specific duhet patjetër një argumentim teknik për secilin se ku duhen. APP kur asiston argumentimin teknik në këto raste e ka shumë të rëndësishëm.

**Commented [u5]:** Duke qenë se është kërkuar shumë staf dhe specific duhet patjetër një argumentim teknik për secilin se ku duhen. APP kur asiston argumentimin teknik në këto raste e ka shumë të rëndësishëm.

**Commented [u6]:** Kriteret 2.3.7 2.3. dhe 2.3.9 janë deklarata që unë i shtova duke qenë pajisje me garanci që dhe duhen instaluar.

2.3.9 Operatori Ekonomik duhet të deklarojë garancinë e mallrave objekt prokurimi e cila duhet të jetë sipas specifikimeve teknike. Gjatë periudhës së garancisë ofertuesi duhet të sigurojë riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë konform specifikimeve teknike.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër se mallrat objekt prokurimit janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara si dhe marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet riparimi, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

### 1. Set kompjuterik (PC + Monitor+Mouse+Tastjerë)

<b>Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net</b>	~12,900 point
<b>Memoria RAM:</b>	min. 8GB DDR4, 3200 MHz
<b>SSD:</b>	min. 512 GB
<b>Portat:</b>	4 x USB 3.2, 4 x USB 2.0, mic, headphone, Audio in/out, DP/DVI/HDMI, 2 x M.2, 1 x PCIe x 16, 2 x Sata
<b>Rrjeti:</b>	10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port, Wireless, Bluetooth
<b>DVD RW</b>	Po
<b>Sistemi operimit:</b>	Windows 10, 64 bit i licencuar
<b>Monitori:</b>	LCD ose LED i të njëjtës Markë me Kompjuterin
<b>Madhësia:</b>	≥ 23”
<b>Rezolucioni:</b>	1920 x 1080 @ 60 Hz
<b>Raporti i kontrastit:</b>	1000:1



<b>Portat e lidhjes:</b>	VGA/DP/DVI/HDMI
<b>Koha e rifreskimit:</b>	≤ 6 ms
<b>Kursi i energjisë:</b>	Energy Star
<b>Burimi i ushqimit:</b>	220 V AC, 50 Hz
<b>Set:</b>	3 Button Scroll Optical + Standard Keyboard QWERTY
<b>Markuar CE:</b>	Po
<b>Garancia:</b>	3 vjet
<b>Sasia</b>	8 copë

*Për hartimin e specifikimeve teknike të këtij seti kompjuterik jemi bazuar në karakteristikat minimale mes modeleve të kompjuterave desktop 1 dhe desktop 2, të mirëpërcaktuar të specifikimet teknike të standardeve TIK 2023-2024, të publikuara ene faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Bazuar në koherencën e lëvizjeve teknologjike të mikroprocesoreve për të pasur një kompjuter të kohëve të fundit është zgjedhur një CPU me pikë minimale 12,900. Për shkak të trajnimeve të shumta që do zhvillohen me keto sete kompjuterike dhe per arsye vizive është zgjedhur ekrani minimalisht 23 inç.*

## 2. Kamera Web

<b>Kamera web</b>	FullHD 1080P, autofokus, 30fps, aftësi mbulimi të imazhit deri 5 m, këndi: 72°, plug&play, porta komunikimit usb 3.0, kapak mbulimi, mikrofon dual me filter eliminimin e zhurmës, tripod, e përshtatshme për sistemet operative: windows, android, linux, mac, smart tv, Markuar CE
<b>Garancia:</b>	1 vit
<b>Sasia</b>	8 copë

*Bazuar në trajnime të shumta që planifikohen të zhvillohen është menduar të merren kamera gjysëm-profesionale, të cilesise së mesme, që kapin imazhe deri në 5m, të lehta për instalim/përdorim, që mundësojnë eliminimin e zhurmës në sfond, me tripod që mund të ndihmojë qëndrimin mbi tavolinë dhe të përshtatshme me sistemin operativ windows ose të tjerë.*

## 3. Kamera WebPro

<b>Kamera webpro</b>	2xFullHD 1080P, 30fps, 5× zoom, këndi: këndgjerë deri në 90°+/-5%, kamera e bazës: e rrotullueshme deri në 180°, kamera e kokës: e rrotullueshme deri në 270°, mundësi rrotullimi manuale, përthyerje deri
----------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

---

në 30°, mundësi për plane/video-regjistrime të ndryshme në të njëjtën kohë.

E përshtatshme për: videokonferenca, transmetim live, fotografim/video, video-regjistrim etj.

Fiks-fokus, plug&play, porta komunikimit USB C, mikrofon digjital me filter eliminimin e zhurmës, e vetë-qendrushme

Punon me aplikacionet si: Skype, Zoom, Youtube, Facebook, Tiktok, Messenger, dhe programe të tjera video.

E përshtatshme për sistemet operative: windows dhe mac

Markuar CE

---

**Garancia:** 1 vit

---

**Sasia** 1 copë

---

*Bazuar në trajnime të shumta që planifikohen të zhvillohen është menduar të merren kamera profesionale me 2 kamera në trup, të cilësisë së lartë, të lehta për instalim/përdorim, zmadhim 5x, me këndgjerë deri në 90° +/-5%, me kamerën e bazës: të rrotullueshme deri në 180°, me kamerën e kokës: të rrotullueshme deri në 270°, mundësi rrotullimi manuale, përthyerje deri në 30°, mundësi për plane/video-regjistrime të ndryshme në të njëjtën kohë. E përshtatshme për: videokonferenca, transmetim live, fotografim/video, video-regjistrim etj. Fiks-fokus, plug&play, porta komunikimit USB C, mikrofon digjital me filter eliminimin e zhurmës, e vetë-qendrueshme. Punon me aplikacionet si: Skype, Zoom, Youtube, Facebook, Tiktok, Messenger dhe programe të tjera video. E përshtatshme për sistemet operative: windows dhe mac*

#### 4. Wireless

- Router Wireless Wi-Fi Gigabit me dy banda frekuencash 2.4GHz + 5GHz
- Wi-Fi – 600Mbps në frekuencën 2.4GHz + 1300Mbps në frekuencën 5GHz
- Shpejtësia 1.9Gbps
- Mënyrat e operimit: Wireless router/Access point/media bridge
- Zona e mbulimit – min. antena 3 dual band për mbulim të mirë
- Procesor 1GHz Dual-core – Siguron vazhdimësinë e punëve të shumta nga rrjeti fizik dhe ai valor
- Ndërfaqe menaxhimi për pajisjet me sisteme operimi iOS dhe Android
- Porta USB për “Fast Sharing”
- Shpejtësi transferimi 10x
- Përdorim i gatshëm për Print Server/Media Server/ FTP Server
- Fikje/ndezje e lehtë e shpërndajës së valëve On/Off
- Kontroll aksesi/Kontroll prindëror/skedulim aksesi/përcaktimi i rregullave
- Menaxhim i thjeshtë brezi (Bandwidth)
- Suporton VPN (PPTP, L2TP, IPSec)
- Enkriptime të shpejta dhe të sigurta
- Portat e rrjetit: 4 x 10/100/1000Mbps LAN dhe 1 x 10/100/1000Mbps WAN
- Porta USB: 1 USB 3.0 + 1 USB 2.0;

- Butona fizik: WPS/Reset, Wireless On/Off, Power On/Off
- Standardet e komunikimit valor: IEEE 802.11ac/n/a 5GHz, IEEE 802.11b/g/n 2.4GHz
- Funksionet valore: Aktivizo/çaktivizo, radio vale, WDS Bridge, WMM, statistika
- Siguria e valëve: enkriptime 64/128-bit WEP, WPA/WPA2, WPA-PSK/WPA-PSK2
- Lloji i lidhjes WAN: Dynamic IP/Static IP/PPPoE/PPTP(Dual Access)/L2TP(Dual Access)/Bigpond
- DHCP: Server, Client, DHCP Client List, Address Reservation
- Cilësia e shërbimit: WMM, Bandwidth Control
- Port Forwarding: Virtual Server, Port Triggering, UPnP, DMZ
- DNS: DynDns, Comexe, NO-IP
- Siguria e Firewall-it: DoS, SPI Firewall, IP Address Filter/Domain Filter, IP and MAC Address Binding
- Protokollet: IPv4 dhe IPv6
- Sistemet e operimit: Windows, Mac
- Markuar CE
- Garancia: 1 vit
- Sasia: 2 copë

*Mbulimi i zonës me wireless, do të mundësojë lidhjen në rrjet/internet të pajisjeve kompjuterike, kamerave web, seti i audios së lëvizshme, smart TV sikurse edhe sistemit të kamerave të vëzhgimit.*

#### 5. Set audio e lëvizshme (Mixer-Amplifikator + mikrofonë + stenda + aksesorë lidhjeje)

Specifikimet teknike Mixer-Amplifikator + mikrofonë + stenda + aksesorë lidhjeje	
<b>Fuqia:</b>	2x250-Watt, sistem i lëvizshëm PA me 6-kanale
	6 Kanale - 2xXLR kanale, 2x kanale Digjital me valë (Wireless),
<b>Portat hyrëse:</b>	2x1/4"TRS&2xRCA kanale të pabalancuara Teknologji komunikimi me valë -Bluetooth dhe Wireless USB: 1 x Type A (ULM wireless ready)
<b>EQ kanal:</b>	2 Band-Treble, Bass
<b>Portat dalëse:</b>	2 x 1/4" (dalje boks) TS L-R
<b>Frekuenca e punës:</b>	70Hz-22kHz
<b>Amplifikuesi:</b>	Fuqia dalëse max. 2x250W 40hm për kanale Stereo
<b>2 x bokse:</b>	8" Woofer dhe 1" Compression Driver

<b>Burimi i ushqimit:</b>	220-240V 50/60Hz
<b>1 x Mikrofon me kabull (Wired):</b>	Dinamike, frekuenca e punës: 90hz-15Khz, konektori: 3-pin balanced XLR + aksesorë (mbajtëse e mikrofonit dhe kabujt audio) + çanta
<b>1 x Mikrofon pa kabull (Wireless):</b>	Set mikrofonësh pa kabujt Wireless (2 mikrofone): Digjitale 2.4 GHz transmetim radio, me funksion "mute", marrësi ushqehet nga porta e USB-së
<b>Veçoritë:</b>	Lidhje dinamike (së paku 4) ose mikrofon condenser (së paku 2), mikrofon wireless (së paku 2), lidhje me iPod, iPhone, ose MP3 player nëpërmjet Bluetooth
<b>2 x stenda boksesh:</b>	Set profesional stendash, lartësia maksimale që mund të mbajë deri në 30 kg, Lartësia: 1.25 m – afërsisht 2.00 m; Diametri stendës: 35mm, çantë
<b>Markuar CE:</b>	Po
<b>Garancia:</b>	2 vjet
<b>Sasia:</b>	1 copë

*Kjo pajisje do të përdoret për të mundur dëgjimin e audios me fuqi të madhe (sinjalit audio) në rastet e trajnimeve të ndryshme apo dhe organizimeve të takimeve me shumë të rinj.*

## 6. Set Aparat profesional fotografik + Lente

<b>Sensori imazhit:</b>	Rezolucioni max. 6000 x 4000 së paku 24.1MP, Sistemi i Pastrimit të Integruar
<b>Lente:</b>	EF/EF-S
<b>Stabilizimi i imazhit:</b>	Stabilizues optik imazhi në lente të pajtueshme
<b>Filtri me Kalimin e Ulët:</b>	I integruar/I fiksuar
<b>ISO:</b>	Auto, 100-25600 (arrin deri në 51200)
<b>Numri i pikave të fokusit:</b>	së paku 42 pika Cross-type AF

<b>Gjatësia fokale</b>	mult. 1.6×
<b>Veçori për videot:</b>	Full HD video në 60p Format MPEG-4, H.264, Mikrofon, Stereo, Speaker Mono
<b>Llojet e kartave për ruajtje</b>	SD/SDHC/SDXC (kompatibël për UHS-I)
<b>Veçori për fotografitë:</b>	Min 30sec – Maks. 1/4000 sekonda shpejtësia e diafragmës, prioriteti i ekspozimit, prioriteti i diafragmës, modaliteti ekspozimi manual, subjekti/scene modes, Built-in flash, diapazoni Flash 12.00 m (me ISO 100), shkrepje në vazhdimësi 6.0 fps, mundësi instalimi për flash të jashtëm
<b>Treguesi i kuadrit</b>	Pentamirror, zona mbulimit (Vertikal/Horizontal) Afërsisht 95 % informacion i treguesit: informacioni AF: pikat AF, konfirmimi i zonës së fokusit, selektimi i zonës AF, Thellësia e Shikimit Paraparak të Fushës, balancim automatik i bardhësisë me sensor imazhi, modalitet Live @29fps
<b>Ekрани LCD</b>	Ekran me prekje në kënde të ndryshme 7.7 cm
<b>Portat:</b>	HDMI, Mikrofone, Wi-Fi, NFC dhe Bluetooth
<b>Telekomandë:</b>	Po (nëpërmjet telefonit ose telekomandë Bluetooth)
<b>Optika dhe Fokusi</b>	Autofokus, dedektor Kontrasti (sensor), Phase Detect, Multi-area, Center, Selective single-point, Tracking, Single, Continuous, Touch, Face Detection, Live View, Fokus Manual
<b>Mundësi për printim direkt:</b>	Po
<b>Pjesë fizike</b>	Bateri e rikarikueshme LP-E17 lithium-ion battery dhe karikues, tregues baterie, Power Saving Jetë gjatësia (CIPA) 600
<b>Programet:</b>	Kompatibël me aplikacion në Android dhe IOS
<b>Sistemi operimit që suporton:</b>	Windows 10 / 8.1 / 8 / 7 Mac OS X 10.9 / 10.10 / 10.11 / 10.12
<b>Objektivi:</b>	18-55mm
<b>Markuar CE:</b>	Po
<b>Garancia:</b>	1 vit

---

**Sasia:** 1 copë

---

*Kjo pajisje do të përdoret për të mundësuar fotografimin/regjistrimin me video në rastet e trajnimeve të ndryshme apo dhe organizimeve të takimeve me shumë të rinj.*

## 7. Smart TV

<b>Lloji i produktit:</b>	LED 4K
<b>Madhësia e ekranit:</b>	min. 55"
<b>Rezolucioni:</b>	ULTRA HD 4K - 3.840 x 2.160
<b>Raporti i pamjes:</b>	16: 9
<b>Këndi i shikimit:</b>	178 degrës
<b>Koha e përgjigjes:</b>	8ms
<b>Ndriçimi:</b>	200cd/m2
<b>WiFi dheLAN:</b>	Integrated WiFi dhe portë rrjeti LAN
<b>PROCESORI:</b>	Quad core CPU
<b>Sistemi Operativ:</b>	Android 7.0
<b>TUNERS:</b>	DVB T2 / S2 / C
<b>Klasi energjisë:</b>	A
<b>Regjistrim PVR USB:</b>	Po
<b>Llojet e imazhit:</b>	Standard, Movie, Vivid, Energy Saving, User
<b>Raporti i shkallës së imazhit:</b>	16: 9, Auto, Zoom 1, Zoom 2, Point by Point
<b>Tonet e ngjyrave:</b>	Normal, Cool, Warm
<b>Boxet audio:</b>	2x10 W
<b>Rregullimi i zërit:</b>	Standard, Music, Theater, News
<b>Portat dhe ndërfaqet:</b>	HDMIx3 , Ci slot, coaxial, component (adapter, optional), USBx2, Headphone jack, VGA, SCART, LAN, bluetooth
<b>Mbajtëse muri:</b>	Po

---

<b>Burimi i ushqimit:</b>	AC220-240V 50 / 60Hz
<b>Markuar CE:</b>	Po
<b>Garancia:</b>	1 vjet
<b>Sasia:</b>	1 copë

*Kjo pajisje do të përdoret për të mundësuar shikimin e fotove/video-ve/prezantimeve/materiale të tjera në rastet e trajnimeve të ndryshme apo dhe organizimeve të takimeve me shumë të rinj.*

## 8. Regjistruer dixhital video

- Dedektimi i lëvizjeve dhe mbrojtje perimetrike: Detektimi i lëvizjes i bazuar në analiza të thella aktivizohet si parazgjedhje për të gjitha kanalet analoge dhe mund të klasifikojë/analizojë njeriun ose automjetin dhe të reduktojë alarmet e rreme të shkaktuara nga objekte si gjethet, dritat dhe objektet e parrezikshme;
- Të realizojë kërkim të shpejtë sipas objektit ose llojit të ngjarjes;
- Të realizojë njohjen e fytyrës/të realizojë kërkimin e figurës së fytyrës;
- Regjitrime video: deri në rezolucionin 1080p
- HDTVI/AHD/CVI/CVBS/IP video inputs
- Mund të lidhen deri në 6-ch kamera IP (deri në 6 MP)
- Mund të lidhen deri në 4-ch kamera analoge
- Deri në 10 TB kapacitet HDD x 1 SATA
- Kompresimi video: H.265 Pro+/H.265 Pro/H.265/H.264+/H.264
- Video Bitrate: 32 Kbps me 6 Mbps
- Audio Bitrate: 64 Kbps
- Suporton dual stream(Video, Audio&video)
- Portë dalje HDMI/VGA
- Bandwith: 72 Mbps
- Nderfaqe e rrjetit: 1, RJ45 10M/100M
- Protokolle rrjetit: TCP/IP, PPPoE, DHCP, DNS, DDNS, NTP, SADP, NFS, iSCSI, UPnP, HTTPS, ONVIF
- Nderfaqe seriale: RS-485
- Nderfaqe USB 2.0
- Markuar CE
- Garancia: 1 vit
- Sasia: 1 copë

## 9. Kamera vëzhgimi

- Imazh me cilësi të lartë 2 MP, rezolucioni 1920×1080px
- IR: 80m
- Ndriçimi min.: 0.01 Lux @ (F1.2, AGC ON), 0 Lux me IR
- Sinjali: PAL: 1/25s deri 1/50,000s dhe NTSC: 1/30s deri 1/50,000s
- Frame: TVI/CVI/AHD: 1080P@30fps, CVBS: PAL/NTSC

- Lentet: 3.6 mm, 6 mm, 8 mm dhe 12 mm
- Ditën dhe Natën: ICR
- WDR: Digital WDR
- Filtër zhurme: Po
- Rregullimi i këndit: Pan: 0 deri në 360°, anim: 0 deri në 180°, rrotullim: 0 deri në 360°
- Video Output: E ndryshueshme në TVI/AHD/CVI/CVBS
- Niveli i mbrojtjes: IP67 (rezitent nga ujit dhe pluhurit)
- Materiali mbrojtës: metal dhe PVC
- Kushtet e temperaturës gjatë punimit: -40°C to 60°C
- Markuar CE
- Garancia: 1 vit
- Sasia: 4 copë

#### 10. Instalim dhe aksesore

- Kabell RG59 - 1 x200m
- Ushqyes 12V/5A - 1x12
- Aksesore Koka BNC, Powerjack
- Kanalina
- Sasia: 1 copë

*Kjo pajisje do të përdoret për të mundësuar monitorimin me video të zones perimetrale në rastet e trajnimeve të ndryshme apo dhe organizimeve të takimeve me të rinj, apo edhe për raste të incidenteve.*

**Argumentim:** Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 15, pika 3/b dhe nenit 40, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Specifikimet teknike hartohen nga specialisti i fushës për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Në hartimin e specifikimeve teknike, nuk përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.